

KOMISIONI IMPLEMENTUES I RINDËRTIMIT PËR TËRËSITË FETARE
ORTODOKSE NË KOSOVË

KOMUNIKATË PËR SHTYPË – 12 TETOR 2006

Gjetjet arkeologjike në Kishën e Shën Gjergjit

Znj. Angjelina Krasniqi, zëvendës ministre e MKRS, dje, në Kishën e Shën Gjergjit në Prizren u takua me znj. Emma Carmichael, Kryesuese e Komisionit Implementues të Rindërtimit dhe me përfaqësuesin e Këshillit të Evropës, për të diskutuar shqetësimet e fundit lidhur me gjetjet e mbetjeve njerëzore brenda në Kishë, gjatë gërmimeve për themele të reja të Kishës.

Gjatë diskutimit të tyre, të gjithë u pajtuan se çfardo mbetjesh njerëzore të gjetura brenda enterierit të Kishës mund ti takojnë vetëm anëtarëve të respektuar të Kishës Ortodokse të cilët sipas traditës ekzistuese mund të varrosen brenda vet Kishës.

Në mes të zëvendës Ministres dhe Këshillit të Evropës u dakordua se në këtë instancë nuk ka nevojë të kryhet asnjë studim arkeologjik dhe ky vendim u morr me pajtimin e plotë të të gjitha palëve.

Punët e jashtme në Kishën e Shën Gjergjit në Prizren po vazhdojnë sipas planit dhe pritet të kryhen në dhjetor 2006.